



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/343
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I85-2 Prot.
Nr. Dok. 202503646/2

Tiranë __4__/_11_/2025

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë Gjirokastrë*

Drejtuar: **Z. Edmond PEJTRA**
Shef i Komisaratin të Policisë

GJIROKASTËR

Drejtuar: **Z. Altin MERIZAJ**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

GJIROKASTËR

Për dijeni: **Drejtues Madhor Ilir PRODA**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Drejtorinë/Komisariatin e Policisë Gjirokastrë nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu inspektim në ambientet e privimit të lirisë së personit në Drejtorinë/Komisariatin e Policisë Gjirokastrë.

Inspektimi u krye në datën 15.10.2025, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit përbëhej nga z. Vullnet Topalli, znj. Lindita

Dedegjoni dhe z. Hazbi Selita me detyrë Nd/komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

MKPT, bazuar në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar, mund të vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë organet e policisë në nivel vendor, burgjet, qendrat e pritjes provizore të emigrantëve të parregullt, qendrat ku mbahen shtetasit e huaj të privuar nga liria, azilkërkuesit, institucionet psikiatrike dhe shtëpitë e të moshuarve. Inspektimi ishte papalajmëruar

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të të arrestuarve, të ndaluarve dhe të shoqëruarve, të cilat ju garantohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurës standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në Mjediset e Policisë”*.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, të referuara si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e inspektimit të MKPT-së, grupi i inspektimit u takua me drejtorin e DVP Gjirokastrë z. Altin Merizaj dhe zv. Drejtorin z. Altin Demiraj, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e vizitës së inspektimit të MKPT-së në mjediset ku mbahen personat e privuar nga liria në DVP Gjirokastrë.

Drejtuesit e Komisariatit, informuan grupin e inspektimit mbi gjendjen e kushtet, në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit dhe i sigurisë në këtë komisarjat dhe informoi për masat e marra për plotësimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar¹, në lidhje me përmirësimin e disa kushteve sipas normave dhe standardeve, për qëndrimin dhe trajtimin e

¹ Shkresë Nr.K4/I78-2, Prot., datë 25.10.2024 “Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisarjatin e Policisë Gjirokastrë”.

personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, sipas përcaktimeve të bëra në aktet ndërkombëtare dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Grupi i inspektimit pasi mori informacionin e nevojshëm, vijoi me inspektimin e ambientit të shoqërimit dhe atij të sigurisë, për evidentimin e kushteve në të cilat janë ndërtuar dhomat e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë, plotësimin e kriterëve për ndërtimin e dhomave dhe rregullat që zbatohen nga personeli i shërbimit policor për respektimin dhe garantimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, grupi i inspektimit vizitoi edhe zyrat e specialistëve e ndihmës specialistëve të policisë, që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar dhe personat e ndaluar/arrestuar, si dhe kontrolloi e administroi dokumentacionin përkatës, ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona.

Nisur nga informacioni i drejtuesve të policisë, por dhe nga inspektimi i kryer në mjediset e sigurisë dhe të shoqërimit në këtë drejtori, rezultoi se respektimi i të drejtave të personave të privuar nga liria dhe kushtet infrastrukturore në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, në tërësi ishin sipas kriterëve, normave dhe parametrave teknikë të parashikuara në procedurat standarde, që garantojnë sigurinë dhe trajtimin e këtyre personave.

Nga informacioni dhe verifikimi i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të dërguara në përfundim të inspektimit të kryer në vitin 2024, rezulton se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi për afishimin në vende të aksesueshme në korridor dhe brenda në dhomat e shoqërimit, të posterave me të drejtat e personave të shoqëruar, në mjediset e Policisë së Shtetit.
 - a) Ishte afishuar në ambientet e dhomave të shoqërimit, të lista e përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluari/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokatët kryesisht.
 - b) Ishte plotësuar me korrektësi “*Formulari i Raportit të Shoqërimit*” nga punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin e personit, në zbatim të rregullave të përcaktuara në procedurat standarde të punës “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
 - c) Ishte plotësuar regjistri për të miturit në rubrikën “*Persona të pranishëm gjatë intervistimit (prindi, mbrojtësi ligjor, psikolog, përfaqësuesi ligjor)*”

2. Ishte zbatuar rekomandimi për vënien në funksion, të dhomës së shoqërimit për të mitur në konflikt me ligjin.
3. Ishte zbatuar rekomandimi, për lyerjen dhe dezinfektimin e dhomave të shoqërimit dhe dhomave të sigurisë, eliminimin e lagështirës dhe të erës së rëndë të mykut, si dhe për zëvendësimin e materialeve të buta, me qëllim plotësimin e nevojave.
4. Ishte zbatuar rekomandimi për pajisjen e personave të arrestuar/ndaluar me mjetet e domosdoshme për larje, pastrim e dezinfektim.
5. Ishte zbatuar rekomandimi për vënien në funksion në dhomat e sigurisë të zileve të emergjencës, të cilat mundësojnë personat e ndaluar/arrestuar në rast nevojë, për të njoftuar punonjësit e shërbimit të policisë

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se:

6. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për rikonstrukcioni e dhomës së shoqërimit për gra, referuar procedurës standarde me qëllim parandalimin e tentativave për vetëdëmtim të personave të shoqëruar në këtë komisariat.
7. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për pajisjen e dyerve të dy dhomave të shoqërimit me sportel dritare për mbajtjen në vëzhgim/monitorim nga ana e jashtme personat e shoqëruar.
8. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për krijimin e ambientit të ajrimit në mjedisin e sigurisë, për personat e ndaluar dhe të arrestuar

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë gjetjet e këtij inspektimi, si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në Komisaratin e Policisë Gjirokastër, ishte i ndërtuar përgjithësisht sipas kërkesave të ligjit nr. 82/2024, *“Për Policinë e Shtetit”*, dhe procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ku parashikohet se: *“Mjediset/ambientet të*

jenë të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur. Këto mjedise të jenë brenda ndërtesave të drejtorive, komisariateve dhe stacioneve të policisë”².

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës së komisarariatit dhe përbëhej nga 2 (dy) dhoma shoqërimi, të ndara për personat e rritur burra dhe për gra. Ndërsa, intervistimi i të miturve kryhej në ambientet e Njesisë për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunës në Familje, i cili përbëhej nga 3 dhoma. Dhomat e këtij ambienti ishin të kompletuara me tavolina pune për punonjësit e policisë, psikologun, avokatin mbrojtës dhe përfaqësuesin ligjor, si dhe me orëditë e nevojshme si kolltuk e karrige për qëndrimin komod dhe ulur të të miturve, i mbështetur nga UNICEF dhe Qeveria e Norvegjeze, në kuadër të programit “Qasja e fëmijëve në drejtësi 2019 – 2020”. Gjithashtu, në këtë drejtori/komisarariat ishin trajnuar 2 punonjës policie për të miturit në konflikt me ligjin.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve. Ato ishin të pajisura secila me 3 karrige të fiksuara në dyshe, që mundësonin qëndrimin ulur të personave të shoqëruar, si dhe ishin të pastra nga ana higjieno sanitare, por **mungonin tavolina** për qëndrimin e personave në konflikt me ligjin në këto ambiente. Përmasat e dhomës së shoqërimit ishin 4x4 m², me kapacitet deri në 12 persona të shoqëruar.

Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin të siguruara me skarë hekuri në pjesën e jashtme, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise. Dritaret ishin me përmasa të tilla që krijojnë mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral. Gjithashtu, dhomat e shoqërimit kanë ndriçim artificial që furnizohet nga rrjeti elektrik, si dhe gjenerator që shërben si burim rezervë në rast ndërprerje të energjisë elektrike. Dyert e dhomave të shoqërimit mbylleen me çelës dhe kanë bravë të rregullt.

Mjediset e dhomave të shoqërimit ishin të mirëmbajtura dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodheshin dy tualete, të ndara më vete për femra dhe meshkuj, me ujë të rrjedhshëm 24 orë dhe të pajisura me të gjitha mjetet e domosdoshme për këtë qëllim. Në vlerësojmë se kushtet higjieno-sanitare janë shumë të rëndësishme në ambientet e privimit të lirisë dhe gjendja e tyre varet nga organizimi i punës dhe për këtë shkak Avokati i Popullit kërkon vëmendje maksimale nga drejtuesit e institucionit dhe stafi përgjegjës. Pastërtia e ambienteve është thelbësore pasi tregon qartë kujdesin ndaj të shoqëruarve në këtë institucion.

² Kreu VI, pika 4, gërmat b dhe c të procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në të gjitha ambientet e shoqërimit ishin vendosur etiketimet sipas dhomave të shoqërimit për të rritur, gra dhe të mitur, siç parashikohet në procedurën standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.

Në ambientin e shoqërimit ishin të instaluara 6 kamera sigurie nga të cilat 2 kamera në korridorin e dhomave të shoqërimit dhe 4 kamera brenda dhomave të shoqërimit, të cilat shërbejnë për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe dhomave të shoqërimit, si dhe monitorojnë veprimet që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar gjatë kryerjes së procedurave që nga hyrja në mjediset e policisë, qëndrimit në dhoma, si dhe gjatë marrjes në pyetje të tyre.

Afati i ruajtjes së pamjeve filmike të siguruara nga kamerat e sigurisë ishte 30 ditë. Ky afat është në kundërshtim me *“Rregulloren për vendosjen dhe përdorimin e sistemit të kamerave të sigurisë në mjediset e brendshme dhe të jashtme, të objekteve ku ushtrojnë aktivitetin strukturat e Policisë së Shtetit”*³, në të cilën është e përcaktuar qartë se: *“Regjistrimet e kamerave të sigurisë do të ruhen për një periudhë deri në 60 ditë dhe më pas do të fshihen automatikisht”*.

Ruajtja e pamjeve filmike të kamerave të sigurisë, sipas legjislacionit kombëtar dhe standardeve ndërkombëtare për këtë qëllim, në vlerësimin e Avokatit të Popullit, përbën një provë të pakontestueshme në procesin e hetimit penal dhe administrativ për rastet që konstatohen kryerje e veprimeve të kundraligjshme si nga personat e privuar nga liria në mjediset e policisë, si nga ana punonjësit të policisë ashtu edhe nga ana e ndaluar/arrestuar. Njëkohësisht, vendosja e sistemit të kamerave në mjediset e brendshme të policisë dhe ruajtja e pamjeve filmike brenda një afati të arsyeshëm, ka efekt parandalues ndaj veprimeve të kundraligjshme që mund të kryhen brenda këtyre mjediseve.

Në ambientin e shoqërimit në korridor, ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Gjithashtu në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa, në gjuhën shqipe dhe disa gjuhë të huaja.

Në Komisariatit të Policisë Gjirokastrë, gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 15.10.2025 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **542** persona, ku konkretisht 504 persona ishin shtetas

³ Miratuar me Urdhrin Nr.1301, datë 03.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

madhorë burra, 26 shtetase gra dhe 12 shtetas të mitur në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 dhe 25/1 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”. Në momentin e inspektimit, **nuk kishte asnjë shtetas** të shoqëruar në dhomat e shoqërimit.

Nga inspektimi i ambientit të shoqërimit u konstatua se, mungonte dhoma e veçantë për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar, e cila duhet të jetë e pajisur me tavolina, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orënditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë⁴, por sipas informacionit të Shefit të Rendit, të shoqëruarit merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Gjithashtu, përgjatë inspektimit konstatuam se personave të shoqëruar nga policia **nuk ju jepej informacioni për të drejtat e tyre në formë shkresore, që nga fillimi i privimit të lirisë, për të siguruar informim të qartë në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë.** Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës sugjeron dhënien e kartës të drejtave që në momentin e hyrjes në komisarjat⁵. Rekomandimi i KPT-së, në përmbajtjen e tij nënkupton që karta me të drejtat që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, **duhet t’u jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit**, pra që në momentet e para të privimit të lirisë. Pasi këtyre personave ju kufizohet liria deri në 5 orë (maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ata merren në pyetje nga specialistët e policisë dhe kanë të drejtën për njoftimin e familjarëve të tyre, të drejtën për qasje me avokat mbrojtës, etj. Aktualisht, karta me të drejtat jepet vetëm në momentin kur i ndaluar/arrestuari merret në pyetje nga OPGJ dhe hyn në dhomat e sigurisë.

Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me “*Kartën e të drejtave*” në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisarjat policie. Nëpërmjet “*Kartës së të drejtave*” qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij.

“*Karta e të Drejtave*” i shërben jo vetëm qytetarit, por edhe vetë Policisë së Shtetit, për të mirëmbajtur besimin e qytetarëve tek Policia, për ta forcuar bindjen

⁴ Kreu VI, Pika 3/d e procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*” miratuar me Urdhrin Nr.894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

⁵ Raporti i Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues (KPT), gjatë vizitës së tyre në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018.

se ajo është një instrument profesional shërbyes dhe jo dhunues i qytetarëve, si dhe për të evidentuar e veçuar abuzuesit me uniformën e policisë.

Vendosja në dispozicion të çdo qytetari të “Kartës së të Drejtave” është një standard të cilin Avokati i Popullit kërkon vazhdimisht që të respektohet. Kjo praktikë është vlerësuar edhe nga Komiteti European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues-KPT-ja, i cili e përshendeti zhvillimin e kësaj praktike për kartën edhe thellimin e saj, duke kërkuar që punonjësit në zyrën e pranimit të sigurohen që të shoqëruarit duhet të shkruajnë e lexojnë dhe e kuptojnë përmbajtjen e kartës.

Në Komisariatit e Policisë Gjirokastrë, në katin e dytë të institucionit ishte një dhomë e mbajtjes së provave materiale dhe sipas informacionit të drejtuesve të komisaritit provat materiale futen në një qese të etiketuar në këtë ambient.

Gjatë inspektimit u evidentuan disa praktika, nga ku rezultoi se në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisariatit e Policisë Gjirokastrë, mbahej procesverbali përkatës dhe pasi firmosej, një kopje i jepej personit të shoqëruar dhe një kopje ruhej në arkivën e institucionit.

Ambientet e sigurisë/kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve

Dhomat e sigurisë në Komisariatit e Policisë Gjirokastrë ishin Përgjithësisht të ndërtuara, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, dhe procedurat standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin nr. 1720, datë 20.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ambienti i sigurisë përbëhej nga 8 (tetë) dhoma sigurie, me kapacitet për 9 (nëntë) persona. Ato ishin të ndara në 6 (gjashtë) dhoma për burra, 1 (një) dhomë për gra dhe 1 (një) dhomë për të mitur.

Dhomat e sigurisë janë të ndërtuara përgjithësisht sipas parametrave teknik të përcaktuara në procedurën standarde, të ndara në dy ambiente me një skarë hekuri dhe derë, në ambientin për fjetje dhe në paradhomë. Nisur nga hapësira dhe sipërfaqja e secilës dhomë, ato plotësonin normat dhe parametrat teknike jetësore për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më

pak se 10 metra katrorë, ambienti i qëndrimit me sipërfaqe 6 m² dhe paradhoma me sipërfaqe 4 m².⁶

Çdo dhomë ishte e pajisur me një krevat metalik me këmbë të palëvizshme dhe ishte e kompletuar me dyshek, batanije dhe jastëk. Në ambientin e qëndrimit ndodhej dhe tualeti, ndërsa në paradhomat e çdo dhome sigurie ndodhej një lavaman me çezmë që kishte ujë të rrjedhshëm, i cili përdorej për pastrimin vetjak.

Dritaret e dhomave kishin përmasa të tilla që krijojnë mundësinë e depërtimit të ajrit dhe dritës natyrale. Ato furnizoheshin me energji elektrike nga rrjeti elektrik dhe në rast ndërprerje, kishte gjenerator si burim alternativ.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larjen e trupit në një ambient të posaçëm i cili ishte një dushi⁷, me ujë të ngrohtë, i cili ndodhej brenda korridorit, në ambientin e sigurisë.

Dhomat e sigurisë ngroheshin me sistem qendror të ngrohjes me kalidajë gjatë periudhës së dimrit, sikurse parashikohet në procedurën standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

Në korridorin e ambientit të sigurisë, kishte aparat telefoni fiks për të mundësuar lidhjen e punonjësit të shërbimit në dhomat e sigurisë me sallën operative të komisarariatit, në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, si dhe për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Në dhomat e sigurisë ishin instaluar buton zile/sinjali për kontaktin me punonjësin e policisë në rast nevojë e të arrestuarve/ndaluarve.

Në ambientin e sigurisë ndodhej dhoma e mjekut, e cila shërben për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të ndaluar/arrestuar, ruajtjen e dokumentacionit që mbahet prej tij, si dhe mbajtjen e medikamenteve të nevojshme për rastet e

⁶ Kreu VII, pika 3.3 e Urdhrit nr.1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

⁷ Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*. “Pika 9. Ambienti për larjen e trupit. 9.1 Brenda sistemit të dhomave të sigurisë ndërtohen dhe funksionojnë ambiente të posaçme që shërbejnë për larjen e trupit të arrestuarve/ndaluarve.”

urgjencave. Kur gjendja shëndetësore e të ndaluarit/arrestuarit paraqitet e përkeqësuar, me rekomandimin e mjekut, personi shoqërohet menjëherë për në Spitalin Rajonal të Gjirokastrë.

Dhoma ishte e pajisur me shtrat për kryerjen e vizitave mjekësore, tavolinë pune, karrige dhe një raft prej druri i mbyllur me bravë për mbajtjen e regjistrave dhe të barnave mjekësore. Ngrohja e ambientit realizohej me ngrohje qendrore.

Brenda ambientit të sigurisë ndodhej edhe dhoma për marrjen në pyetje të ndaluar/arrestuarve nga prokurorët apo oficerët e policisë gjyqësore, e cila shërbente njëkohësisht dhe për takimin e këtyre personave me avokatët mbrojtës, e cila ishte e monitoruar nga sistemi i kamerave. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige me këmbë të fiksuara në dysHEME në mënyrë të palëvizshme për qëndrimin ulur të personave, të cilat ofrojnë kushte pune për përfaqësuesit e organit të akuzës, si dhe për avokatin mbrojtës të tyre.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me 3 kamera, përgjatë 24 orëve. Kamerat administroheshin nga punonjësi i IT-së në DVP Gjirokastrë dhe afati i ruajtjes së pamjeve filmike ishte për 30 ditë.

Nga informacioni i punonjësve të policisë, rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në vendimin nr. 189, datë 15.03.2017 *“Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”*. Atyre ju sigurohen 3 vakte ushqim në ditë, që përgatiten nga një subjekt privat sipas kontratës së lidhur me DVP Gjirokastrë dhe servirej me shërbim katering.

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të arrestuar/ndaluar, dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet këtyre personave nga ana e punonjësve të policisë

Nga verifikimi i regjistrit ku evidentohen të dhënat e personave të ndaluar/arrestuar, për periudhën janar - tetor 2025, kanë qëndruar në dhomat e sigurisë 205 persona, nga të cilat 3 gra dhe 2 të mitur. Referuar statistikave për këtë periudhë, në dhomat e sigurisë nuk rezultoi të ketë patur situata mbipopullimi.

Koha e qëndrimit në dhomat e sigurisë e personave të arrestuar, ishte deri 96 orë për vlerësimin e masës së arrestit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk ka një vend (dhomë më vete) kult, të ndaluarit/arrestuarit që dëshironin, u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

Në mungesë të ambientit të ajrimit, sipas punonjësve të policisë në dhomat e sigurisë, ajrimi dhe pirja e duhanit kryheshin në ambientin e paradhomës.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, nuk rezultoi të kishte raste apo pretendime të evidentuara për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike, nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Sipas parashikimeve në dispozitat e ligjit nr. 82/2024, *“Për Policinë e Shtetit”*, si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, çdo njësi policore ku ka dhoma shoqërimi dhe dhoma sigurie, duhet të jetë e pajisur me regjistrat përkatës.

Theksojmë se, nga verifikimi i regjistrave dhe librave të shërbimit në Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë, u evidentua se regjistrat ishin të sekretuar dhe vulosur, sikurse përcaktohen në modelet tip të miratuar në procedurat standarde.

Konkretisht, në zyrën e informacionit ndodhej *“Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”* sipas tipit “Model nr.1”, konform me procedurën standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme **nga 1 orë deri në 5 orë** në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit⁸ dhe ishte i sekretuar.

Në këtë komisariat mbahej dhe regjistri me të dhënat e personave të ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij komisariati, i cili gjithashtu ishte i sekretuar.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në komisariatin e policisë Gjirokastrë në DVP Gjirokastrë. Në procesverbalin e arrestimit apo ndalimit, ishte shënuar ora kur personat ishin mbajtur të shoqëruar në mjediset e policisë, pra në momentin kur atyre ju ishte privuar liria.

Grupi i inspektimit, konstatoi se në këtë Komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr. 82/2024 “*Për Policinë e Shtetit*”, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Në këtë institucion administrohej regjistër për të miturit e shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë muajit janar të vitit 2025 kishte 12 të mitur në konflikt me ligjin, sipas procedurës standarde (Lidhja model 5).

Në Komisariatin e Policisë Gjirokastrë u konstatua gjithashtu se kishte edhe regjistër për takimet me avokatin mbrojtës dhe prokurorin, regjistër të vizitave mjekësore, regjistër të shoqërimit të personave në ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, regjistër të marrjes në pyetje nga prokurorët e çështjes, si dhe karta e të drejtave të personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar në gjuhën shqipe në disa gjuhë të huaja.

Avokati popullit thekson se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standart thelbësor me funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

⁸ Kreu VII, e procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

Ambientet e intervistimit

Në Komisariat e Policisë Gjyqësore, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me të shoqëruarit në mjediset e policisë, në zyrat e punës së tyre, për shkak të mungesës të ambienteve të veçanta për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar. Këto zyra, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme ka rekomanduar marrjen e masave për ndërtimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera pranë tyre, por është konstatuar se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar⁹.

Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ashtu si nga punonjësit e policisë së shtetit dhe nga vetë ndaluarve apo arrestuarve. Kjo problematikë është evidentuar edhe në gjetjet e KPT -së në raport të drejtuar shtetit shqiptar.

Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT-së në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit: *“Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.*

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare.”

KPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-

⁹ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”

vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të shoqëruar.¹⁰

Në lidhje me intervistimin/marrjen në pyetje të personave të mitur, sikurse e përmendëm edhe më lart, ishte krijuar “*Njësia për intervistimin e të miturve*”, e cila ndodhej gjithashtu brenda teritorit të komisariatit të policisë. Ky ambient përbëhet nga 4 dhoma të ndara më vete, të pajisura me orëditë e nevojshme si tavolina për punën e specialistëve të policisë, si dhe karrige për qëndrimin ulur të të miturve, kujdestarit ligjor dhe avokatit mbrojtës.

DVP Gjirokastrë ka në organikë 2 specialistë policie të trajnuar për këtë qëllim, gjithashtu në këtë ambient, ishin të afishuara postera informuese mbi të drejtat e të miturve kur ndodhen në mjediset e policisë, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga punonjësit e policisë gjatë intervistimit të tyre.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Në komisariatit të Policisë Gjirokastrë, punonjësit e policisë zbatonin detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 19/5 dhe 25/5 të ligjit nr. 82/2024 “*Për Policinë e Shtetit*”, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi rezultoi, se për personat e shoqëruar mbahej procesverbali tip “*Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit*”. Njëkohësisht, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale, që të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet një kopje e procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre ju sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Sipas informacionit, përgjithësisht avokati paraqitet në mjediset e policisë jo më vonë se 1 orë nga momenti i njoftimit nga personeli i shërbimit ose nga specialistët

¹⁰ Electronic recording of police interview (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

e policisë të ngarkuar për kryerjen e veprimeve procedurale me të shoqëruarin apo të arrestuarin e dyshuar për kryerjen e veprës penale. Në regjistrin ku evidentohen takimet e të arrestuarit me avokatin mbrojtës, shënohej emri dhe mbiemri i avokatit, si dhe ora e takimit, por jo ora e njoftimit.

Përgjatë inspektimit në Komisariatit e Policisë Gjirokastër, **u konstatua se nuk kishte një listë të afishuar në ambientet e komisarariatit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht, si dhe nuk ishte evidentuar në regjistrin e informacionit nëse avokatët kishin qenë të pranishëm.** Gjithashtu kjo problematikë është trajtuar në raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

KPT-ja bën rekomandime të hartuara për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Gjithashtu kërkohet veprim për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë. KPT-ja gjatë vizitës në organet e Policisë së Shtetit ka konstatuar se: *“Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar **për avokat kryesisht** vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati”*¹¹.

Përgjatë inspektimit punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Gjithashtu, u evidentua se në mjedisin e shoqërimit mungonte edhe lista e psikologëve e miratuar nga Urdhri i Psikologut në Tiranë. Pavarësisht kësaj, në rastet kur i shoqëruari apo i ndaluar/arrestuari ishte i mitur, psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, por edhe në bashkëpunim me Bashkinë dhe Shkollën e Mesme të qytetit në Gjirokastër. **Mekanizmi Kombëtar kërkon që avokati dhe psikologu të jenë të pranishëm,** që në në momentin e hyrjes të të shoqëruarve në komisarariat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre dhe mbështetje psikologjike në rrethanat në të cilat këta shtetas ndodhen në institucion.

Grupi i monitorimit konstatoi se, vizitat mjekësore nga ana e mjekut part-time kryheshin brenda afatit 12 orë, nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurave

¹¹ <https://rm.coe.int/1680ae233b>, fq nr.3, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”¹².

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Në regjistrin e mjekut ishin të evidentuara të gjitha të dhënat e konstatuara përgjatë vizitës mjekësore të personave të arrestuar.

Nga informacioni i marrë nga stafi, u informuam se shërbimet shëndetësore për personat e ndaluar/arrestuar kryhen nga mjeku i emëruar me kohë të plotë në këtë institucion, ndërsa për raste urgjente të ndaluarit/arrestuarit dërgohen në Spitalin Rajonal Gjirokastrë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e mjedisit të shoqërimit dhe të sigurisë të komisariatit, ishin të afishuara postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar, si në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për gjetjen e fondeve për riparimin e dyerve dhe dritareve të dhomave të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Gjirokastrë, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VI, pika 4 të procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë

¹² Kreu V, pika 7.2 e procedurave standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”.

institucion, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisariatit.

3. Marrjen e masave për vendosjen e tavolinave në dhomat e shoqërimit sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.
4. Të merren masat e menjëhershme, për sigurimin e ruajtjes së pamjeve nga kamerat e sigurisë, deri në 60 ditë, sikurse përcaktohet në “Rregulloren për vendosjen dhe perdorimin e sistemit të kamerave të sigurisë në mjediset e brendshme dhe të jashtme, të objekteve ku ushtrojnë aktivitetin strukturat e Policisë së Shtetit”.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për afishimin në ambientet e dhomave të shoqërimit, të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluar/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokat kryesisht.
6. Marrjen e masave të nevojshme, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisariatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut, Tiranë.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore personave të shoqëruar apo ndaluar që në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

**Ahmet PRENÇI
dv**

